



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 4382 Prot.

Patos, më 12 / 12 / 2024

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM
Nr. 92, datë 12 / 12 / 2024

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME PËR VITIN 2025

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në nenin 54 shkronja “ç” të ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, shkronja “b” neni 140, nenit 149 Kreu XIV ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe pika 11 e V.K.M-së nr. 328, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Marrëveshjes së Furnizimit nr. 4235/1 prot., datë 06.12.2024 e nënshkruar nëpërmjet Fondit Shqipëtar të Zhvillimit dhe Bashkisë Patos me objekt “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të bashkëpunimit të përbashkët–materiale dhe lëndë të parë pune, për realizimin e punimeve për projektin “Rehabilitimi i Përroit në Lagjen e Re, Bashkia Patos” grupi punës,

PROPOZON:

- Miratimin e 10 (dhjetë) punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025.
- Efekti financiar të mbulohet nga fondet e trashëguara sipas analizës së realizimit të pritshëm të Buxhetit të vitit 2024.
- Për zbatimin e këtij projektvendimi pas miratimit në Këshillin Bashkiak, ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Informimit Publik, Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Financës.

NR.	EMËRTIMI	NUMRI I PUNONJËSVE	KATEGORIA	ARSIMI	PAGA E GRUPIT	SHTESË VJETËSIE	SHTESË POZICIONI
1.	Specialist ndërtimi	2	Pika 11	I mesëm	0	1%	47 000
	Punëtor ndërtimi	8	Pika 11	I mesëm	0	1%	40 000

Drejtuese e Programit Menaxhimit dhe Administrim Juela Shpata

Drejtuese e Programit Rrjeti Rrugor Rural Ermenita Mici

Drejtuese e Programit Shërbimeve Publike Vendore Eneo Xhaferi

Përgjegjëse e Sektorit Juridik Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

Nr. 4392/11 Prot.

Patos, më 12/12/2024

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2025”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në nenin 54 shkronja “ç” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, shkronja “b” neni 140, nenit 149 Kreu XIV ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe pika 11 e V.K.M-së nr. 328, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Marrëveshjes së Furnizimit nr. 4235/1 prot., datë 06.12.2024 e nënshkruar nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Patos me objekt “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të bashkëpunimit të përbashkët –materiale dhe lëndë të parë pune, për realizimin e punimeve për projektin “Rehabilitimi i Përroit në Lagjen e Re, Bashkia Patos” kërkojmë miratimin e 10 (dhjetë) punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2025.

Pagesa e punëtorëve do të bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave si për punonjësit organik 47000 (dyzet e shtatë mijë lekë) për specialist ndërtimi dhe 40000 (dyzet mijë lekë) për punëtor ndërtimi për një periudhë 6 mujore dhe do të përfshihen në shpenzimet e personelit.

Efekti financiar bashkë me sigurimet shoqërore është 2 900 000 mijë lekë dhe do të mbulohet nga fondet e trashëguara sipas analizës së realizimit të pritshëm të Buxhetit të vitit 2024.

Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë Patos që të miratojë numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme të propozuara nga ekzekutivi, si të bazuara në ligj dhe në strukturimin më të përshtatshëm që i përgjigjet nevojave të institucionit tonë.

DREJTORE
Juela Shpata

